



Gj - 25 - 07 - 2017 NË EMËR TË POPULLIT
*Më
Dana*

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I
 PËRGJITHSHËM PENAL, me gjyqtarin e vetëm gjykues Ilir Bytyqi dhe procesmbajtësen
 Kadishe Shabani, zyrtaren ligjore, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED] nga
 Fsh. [REDACTED] K. Ferizaj, për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 par. 1 të
 KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II. nr. 607-1/2017 e datës
 26.04.2017, pas mbajtjes së shqyrimit gjyqësor me datë 15.11.2017, në praninë e
 përfaqësuesit të aktakuzës – Prokurorit të Shtetit Valdet Avdiu, përfaqësuesit i të dëmtuarës
 DBP-Ferizaj, [REDACTED], si dhe të pandehurit [REDACTED] të njëjtën datë mori dhe
 publikisht shpalli, ndërsa me datën 19.11.2017 përpiloj me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri [REDACTED] i lindur më [REDACTED] në [REDACTED], me vendbanim në
 Fshati [REDACTED] K. Ferizaj, nga i ati [REDACTED] dhe nëna [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], i martuar, prind i
 tre fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me
 numër personal [REDACTED]

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 01.04.2017, rrëth orës 20:00, në pyllin e quajtur "Te Prroni i Madh" në
 rajonin ekonomiko-pyjor "Neredime-Jezerc", me të cilin Qeveris Drejtoria për Bujqësi,
 Pylltari dhe Zhvillim Rural-Ferizaj, i pandehuri me qëllim për të vjedhur me sharrë
 motorrike, ka prerë 1 copë trungje-lisa, të llojit ahu, me diametër 60 cm, të gjata boriteti III,
 me vëllim të përgjithshëm 3,00 metër kub, me ç 'rast të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm në
 vlerë prej 405,00 euro.

me të cilën ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par. 1 të KPRK-së

Andaj, Gjykata në bazë të nenit te sipërcituar dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPRK-së, e

G J Y K O N

- Me dënim me gjobë në lartësi prej 250 €/dyqind e pesëdhjetë/ të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Nëse dënimini me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra tjera të parapara në nenin 46 të KPRK-së, i njëjti do ti shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1/një/ ditë burg.
- Obligohet i pandehuri që të dëmtuarës Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari në Ferizaj në emër të kërkesës pasurore juridike t'i kompensoj shumën në vlerë prej 405,00€ (katërqind e pesë), në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënrim të përmbarimit me dhunë.
- Obligohet i akuzuari që në emër të pashallit gjyqësor, të paguajë shumën 30 /tridhjetë/€ në afatin prej 15 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënrim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridikcionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet te realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për te cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari individual.

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën e evidentuar PP. II.nr. 607-1/2017 e datës 26.04.2017, ka ngarkuar të pandehurin ██████████ për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj aktakuze caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor me datë 15 nëntor 2017, në të cilën shqyrtim i akuzuari [REDACTED] u deklarua i pafajshëm për veprën për të cilën e ngarkon akuza.

Prokurori i shtetit Valdet Avdiu në fjalën përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë akuzës, dhe ka deklaruar se gjendja faktike e përshkruar ne dispozitiv është vërtetuar në tërësi gjatë këtij shqyrtim gjyqësor nga deklarata e dëshmitarit [REDACTED] si dhe provat e prezantuara në shqyrtim gjyqësor, andaj edhe i propozon Gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe të i shqiptohet dënim i paraparë sipas ligjit.

Përfaqësuesi juridik i DBP-së [REDACTED] në fjalën përfundimtare ka deklaruar se i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe parashtron kërkesë pasurore juridike siq është parashtruar në aktakuzë pra në shumë prej 405,00€.

I akuzuari [REDACTED] në fjalën përfundimtare ka deklaruar se ndihet plotësisht i pafajshëm në këtë çështje penale andaj kërkon nga gjykata që ta liroj nga aktakuza sepse me asnjë provë nuk është vërtetuar se është kryes i kësaj vepre penale.

Pasi qe i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale sipas kësaj akuze, Gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një duke i ndërlidhur reciprokisht njëren me tjetrën, ne kuptim te nenit 361 par. 1 dhe 2 te KPKK-së, vërtetoj gjendjen e fakteve të përshkruar hollësisht ne dispozitivin e këtij aktgjykimit

Se i akuzuari [REDACTED] me datë 01.04.2017, rrëth orës 20:00, në pyllin e quajtur "Te Prroni i Madh" në rajonin ekonomiko-pyjor "Neredime-Jezerc", me qëllim për të vjedhur me sharrë motorrike, ka prerë 1 copë trungj-lisa, të llojit ahu, me diametër 60 cm, të gjata boniteti III, me vëllim të përgjithshëm 3.00 metër kubë, me ç 'rast të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 405,00 euro.

Këtë gjendje e fakteve si më lart gjykata e vërtetoj nga dëgjimi i dëshmitarit - Roja e Pyllit [REDACTED] i cili në mënyrë bindëse dhe objektive dëshmoj për faktet relevante si dhe bazuar në ditarin e tij personalisht vërteton se ka takuar personalisht të pandehurin dhe i ka marr shënimet personale, te vendi Kroj i Madh (ky vend njifet prroni ose kroi i madhë), gjatë muajit prill të viti 2017 i cili ka qenë duke prerë një lis të llojit ahu me diametër 60 cm,

lisin e ka prerë me motorsharrë, ka qenë i vetëm dhe lisin e ka dërguar në shtëpi me traktor të tipit Ferguson, lisin e kishte lidhur me zinxhir te hekuri për traktori, rimorkio nuk ka pasur me vete. Gjykata i fali besimin plotë dëshmisë së dëshmitarit pylltarit.

Ndërsa nga procesvërbali i përpiluar nga ana e komisionit për vlerësimin e dëmit nr. 181/17 të datës 11.04.2017, gjykata vlerësoj se lartësia e dëmit është 405.00 €uro.

Sa më sipër, u provua ne gjykimin e çështjes me provat e paraqitura nga organi i akuzës dhe të administruara nga Gjykata në seancë gjyqësore, ndër të cilat theksohen:

- fletëparaqitja e rojës së pyllit me numër 49/17 të dt.11.04.2017.
- procesverbali i vlerësimit të dëmit nr.181/17 dt.11.04.2017.

Duke vërtetuar këtë gjendje faktike gjykata konfirmon se në veprimet e të akuzuarve ekzistojnë elementet e veprës penale vjedhje pylli nga nen 358 par. 1 të KPRK-së, andaj gjykata e shpalli fajtor dhe në kuptim të dispozitave ligjore të cituara në dispozitiv të aktgjykit i shqiptoj dënim në të holla në lartësi prej 250 €, të cilët është i obliguar ta paguajnë në afatin prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykit, njëkohësisht gjykata obligoj të akuzuarit që të paguajnë në emër të kompenzimit të dëmjt DBP-së Ferizaj shumën 405.00 €uro, pasi që i pandehuri me veprimet të kundërligjshme dhe me qëllim vjedhje ka prerë lisin në kubaturë prej 3,00 meter kubë i vërtetuar nga procesvërbali i komisionit nr.181/17, andaj dëmin e shkaktuar është i obliguar që të paguajnë, pas plotfuqishmërisë së aktgjykit nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Gjykata çmoj dhe vlerësoj mbrojtjen e të akuzuarve [REDACTED] se kinse nuk ka qenë në pyllin shtetërorë dhe nuk kanë pre dru pa leje, por një mbrojtje të tillë gjykata nuk e aprovoj, nga fakti se nga dëshmia e dëshmitarit-pylltarit [REDACTED] u vërtetua pa mëdyshje dhe në mënyrë të sigurt se i akuzuari ka qenë në pyllin shtetërorë nën qeverisjen e dreitorisë per bujqësi dhe pylltari, zyra regionale në Ferizaj, në territorin e fshatit ekonomiko-pyjore Neredime-Jezerc, në vendin e qujtur "Prroni Madhë" me qëllim vjedhje ka prerë 1 copa dru ahu të njomë me diametër 60 cm. me lartësi boniteti III, në kubaturë prej 3,00 m.kub, në vlerë dëmi prej 405 €, dëshmitari në prezencën e të akuzuarit në seancën kryesore ka vërtetuar për faktet relevante dhe ate kohën, datën dhe vendin ku i ka zanë të akuzuarit duke prerë dru, mjetin me të cilin ka prerë dru pa leje, dhe mjetin me të cilën ka bart drut e pera pa leje, të akuzuarit nuk ishin në gjendje që me pyetje dhe nënpyetje të demantojnë dëshmin e dëshmitarit.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, si rrethanë lehtësuese mori sjelljen korrekte, gjendjen e rëndë ekonomike, është mbajtës i familjes. Nërsa rrethana rënduese gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, e në veçanti vlersojë edhe rrethanen që i pandehuri është gjykuar me vendim të formës se prerë për të njejtën natyrë të vepres penale P.nr.1490/15 dt. 28.04.2016 (bashkangjitur gjeni vendimin).

Gjkata është e bindur se edhe me dënimë të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i akuzuarit në të gjitha fazat e procedurës penale ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, përkatësisht dënim i shqiptuar është plotësish i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe me autoret të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI PERGJITHSHEM,

P.nr. 1010/17 datë 19.11.2017.

Zyrtarja ligjore,

Kadishe Shabani



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.